VENDIM
Nr. 219, datë 13.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI "ZGJERIMI I VARREZAVE MORAVË, NJËSIA ADMINISTRATIVE OTLLAK, BERAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Zgjerimi i varrezave Moravë, Njësia Administrative Otllak, Berat".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.
3. Pronari kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 366 212 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 366 212 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i miratuar për Bashkinë Berat.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Bashkinë Berat.
6. Shpronësimi i pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronari i pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Berat.
8. Bashkia Berat kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, fillon procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Berat.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Berat.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut të Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARIT TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE MORAVË", NJËSIA ADMINISTRATIVE OTLLAK, BERAT

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. i pasurisë	ZK	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e prekur	Çmimi/ njësi, lek/ m^2	Vlera në lek	Shënime
1	Thanas Enver Kristos	1189/25	2723	arë	1804	203	366,212	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Berat
TOTALI							**366,212**	